



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. Prot. 208/1

Tiranë, më 11 / 25 / 2018

Lënda : Mbledhja e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit - AKKSHI

Proces-verbal i mbledhjes së Bordit të Administrimit

Në datën 11.05.2018, ora 14:10, u mbajt mbledhja e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, pranë ambienteve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Pjesëmarrës në mbledhje (anëtarë të Bordit të Administrimit):

1. **Znj. Lindita NIKOLLA** – Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Kryetare e Bordit të Administrimit;
2. **Z. Ervin DEMO** – Zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë; Anëtar
3. **Z. Vasil TOLE** – Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave; Anëtar
4. **Z. Mynyr KONI** – Rektori i Universitetit të Tiranës, Anëtar
5. **Znj. Ejona ISUFAJ** – Përgjegjëse Sektori, Sektori i Derregullimit, Lejeve, Licensave, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Anëtare

Nuk morën pjesë në mbledhje (anëtarë të Bordit të Administrimit):

1. **Znj. Dhurata BOZO** – Drejtor i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Anëtare
2. **Znj. Ines Muçostepa** - Kryetare e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë; Anëtare

Pjesëmarrës në mbledhje (nga AKKSHI):

1. **Z. Geron KAMBERI** – Drejtor i Përgjithshëm i AKKSHI;
2. **Zj. Evis Tasellari** - Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve Bilaterale në rolin e Sekretarisë Teknike

BORDI I ADMINISTRIMIT:

1. Znj. Lindita Nikolla, Kryetare

3. Z. Vasil Tole, Anëtar

5 Znj. Ejona Isufaj, Anëtare

2. Z. Ervin Demo, Anëtar

4. Z. Mynyr Koni, Anëtar

Në datën 11.05.2018, u zhvillua mbledhja e Bordit të Administrimit të AKKSHI, në ambientet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Mbledhja u drejtua nga Znj. Lindita Nikolla, Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Kryetare e Bordit të Administrimit të AKKSHI.

Bordi i Administrimit zhvilloi mbledhjen me këtë rend dite:

1. Miratimi i raportit vjetor i veprimtarisë së AKKSHI 2017.
2. Miratimi i fushave prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit.
3. Miratimi i financimit të projekteve fituese në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, në kuadër të marrveshjes bilaterale midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë.
4. Shpallja e thirrjes për aplikim me projekte në kuadër të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit.
5. Diskutim mbi buxhetin e vitit 2018 të AKKSHI.
6. Të ndryshme.

Znj. Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë- Kryetare në cilësinë e Kryetares hapi mbledhjen e Bordit të Administrimit duke falenderuar të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre dhe më pas fjala ishte për **Z. Geron Kamberi**, Drejtor i Përgjithshëm i AKKSHI.

Znj. Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Kryetare – Mbledhja e Bordit të Administrimit është thirrur me kërkesë të Drejtorit të AKKSHI.

Fjala është për Z. Kamberi.

Z. Geron KAMBERI, Drejtor i Përgjithshëm i AKKSHI – Faleminderit Znj. Kryetare e Bordit. Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës për shkak se Bordi i Administrimit, do të doja të theksoja se për shkak se nuk u arrit të mblidhej brenda muajit Prill për miratimin e Raportit Vjetor të veprimtarisë së AKKSHI, sipas pikës 9 e) të VKM Nr. 607, datë 31.08.2016, raporti është dërguar gjatë muajit Prill të gjithë anëtarëve të Bordit me shkresë zyrtare me Nr.Prot. 236, datë 24.04.2018 nga ana e AKKSHI tek gjithë anëtarët.

Të gjithë anëtarët- E kemi marrë raportin dhe miratojmë përmbajtjen e tij.

BORDI I ADMINISTRIMIT:

1. Znj. Lindita Nikolla, Kryetare

3. Z. Vasil Tole, Anëtar

5 Znj. Ejona Isufaj, Anëtare

2. Z. Ervin Demo, Anëtar

4. Z. Mynyr Koni, Anëtar

Do të doja të filloja diskutimin para Bordit të Administrimit të AKKSHI lidhur me kërkesën e pikës 2 të rendit të ditës që i përket miratimi të fushave prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit.

Duke ju referuar rekomandimit të Bordit të Administrimit të mbledhjes së fundit të datës 31 Nëntor 2017, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit me shkresn Nr. Prot. 62, datë 12.02.2018, për identifikimin e këtyre fushave u ngrit një grup pune, me përfaqësues nga Akademia e Shkencave, që të përcillnin pranë AKKSHI një Raport për fushat prioritare, të cilat do të mbështeteshin në analizën e strategjive kombëtare sektoriale 2014 - 2020 dhe parashikimin e tyre lidhur me prioritetet e zhvillimit.

Në raportin e dërguar pranë AKKSHI me shkresën me Nr.Prot. 71/1, datë 28.03.2018, në bazë të analizës së prioriteteve strategjike dhe duke patur parasysh 7 fushat e mëparshme të Programeve të Kërkim - Zhvillimit AKKSHI 1. Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit 2. Uji dhe Energjia 3. Shëndetësia 4. Shkencat Sociale dhe Albanologjike 5. Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia 6. Biodiversiteti dhe Mjedisi 7. Materialet, u identifikuan si fusha prioritare të kërkimit shkencor sipas kuadrit strategjik kombëtar, si më poshtë vijon:

- I. Bujqësia dhe Siguria Ushqimore;
- II. Shëndetësia;
- III. Energjia, Uji Burimet Natyrore dhe Mjedisi;
- IV. Urbanizimi dhe Infrastruktura;
- V. Shkencat sociale dhe Albanologjia;
- VI. Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit.

Në këto kushte nga ana e Bordit të Administrimit të AKKSHI, kërkohet miratimi fushave prioritare të kërkimit mbi të cilat do të mbështetet financimi i Projekteve Kombëtare të Kërkim - Zhvillimit përkundër 1. Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit 2. Uji dhe Energjia 3. Shëndetësia 4. Shkencat Sociale dhe Albanologjike 5. Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia 6. Biodiversiteti dhe Mjedisi.

Z. Vasil TOLE, Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave, Anëtar- Unë mendoj që fushat prioritare e paraqitura t'i orientojmë në dy segmente kryesore pa hequr asnjërën nga ato, duke qënë se është marrë një mendim i specializuar tashmë, unë propozoj vetëm riorganizimin në dy shtylla. Në këtë pikpamje unë

BORDI I ADMINISTRIMIT:

1. Znj. Lindita Nikolla, Kryetare

3. Z. Vasil Tole, Anëtar

5 Znj. Ejona Isufaj, Anëtare

2. Z. Ervin Demo, Anëtar

4. Z. Mynyr Koni, Anëtar

propozoj që prioritet për Shkencat Albanologjike: 1. Albanologjia; 2. Shkencat Sociale dhe prioritet për Shkencat Natyrore (Teknike), është: 1. Bujqësia dhe Siguria Ushqimore; 2. Shëndeti; 3. Energjia, Uji, Burimet Natyrore dhe Mjedisi.

Z. Mynyr KONI, Rektor i Universitetit të Tiranës, Anëtar - Ka edhe diçka, që më duhet të shtoj dhe pyes. Në rast se miratojmë këto fusha a duhet miratuar edhe një program lidhur se ku do të orientohen kërkimet brenda kësaj fushe prioritare.

Z. Geron KAMBERI, Drejtor i Përgjithshëm i AKKSHI- Në lidhje me pyetjen tuaj në materialin e fushave prioritare, ka disa anekse ku nga Grupi i Punës janë përcaktuar orientimet tematike për projekte kërkimore brenda këtyre fushave sipas prioriteteve specifike për secilën fushë, të mbështetura në strategji.

Z. Vasil TOLE, Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave- Po, e drejtë pasi dokumentat strategjike, i miraton qeveria dhe jo bordi.

Znj. Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë- Për të qënë konkret në diskutim. Me miratimin e këtyre fushave orientojmë financimin e Projekteve Kombëtare të Kërkim- Zhvillimit drejt fushave të përzgjedhura.

Z. Geron KAMBERI, Drejtor i Përgjithshëm i AKKSHI - Po pasi është një detyrim që përcakthet në pikën 8 a) të VKM Nr. 607, datë 31.08.2016.

Znj. Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë- Lidhur me fushat do të biem dakort në formën që na janë propozuar?

Z. Mynyr Koni, Rektor i Universitetit të Tiranës, Anëtar - Kam një propozim, lidhur me përfshirjen e diversitetit biologjik. Në këtë rast do sugjeroj që në fushën III. Energjia, Uji Burimet Natyrore dhe Mjedisi, të bëhet një ndarje ku të dalë Energji, Uji si fushë më vetë dhe Biodiversiteti & Mjedisi si fushë më vete.

Të gjithë anëtarët - Po jemi dakort me këtë sugjerim. Miratohet.

Z. Geron KAMBERI, Drejtor i Përgjithshëm i AKKSHI- Lidhur me fushën IV. Urbanizimi dhe Infrastruktura është një fushë e re që propozohet për këtë fushë nuk kemi Grupe të Ekspertëve Vlerësues pasi ato janë të miratura përkundrejt 7 fushave 1. Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit 2. Uji dhe Energjia 3.

BORDI I ADMINISTRIMIT:

1. Znj. Lindita Nikolla, Kryetare

3. Z. Vasil Tole, Anëtar

5 Znj. Ejona Isufaj, Anëtare

2. Z. Ervin Demo, Anëtar

4. Z. Mynyr Koni, Anëtar

Shëndetësia 4. Shkencat Sociale dhe Albanologjike 5. Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia 6. Biodiversiteti dhe Mjedisi 7. Materialet.

Znj. Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë – Atëherë në bazë të sugjerimeve e propozimeve të mësipërme fushat prioritare që mbeten nga materiali i propozuar janë:

- 1. Bujqësia, Siguria Ushqimore dhe Bioteknologjia;**
- 2. Biodiversiteti dhe Mjedisi;**
- 3. Uji dhe Energjia;**
- 4. Shkencat Sociale dhe Albanologjike;**
- 5. Shëndetësia;**
- 6. Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit.**

Kush është dakort me këtë propozim?

Të gjithë anëtarët -Dakort.

Znj. Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Kryetare - Kalojmë në pikën e III-të të rendit të ditës.

Z. Geron KAMBERI, Drejtor i Përgjithshëm i AKKSHI - Në kuadër të nënshkrimit të Marrëveshjes e Programit të Bashkëpunimit mes MASR- CNR të nënshkruar me 19 Maj 2017, nga ana e AKKSHI u hapën thirrjen për Projektet Bilaterale të Bashkëpunimit Shkencor Dypalësh Itali- Shqipëri. Pas vlerësimit nga Komisionet e Ekspertëve të dy vendeve, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, do të shihni në tabelën e parë të gjithë listën e projektet propozimeve (25- projekt propozime), të cilat kanë aplikuar dhe në tablën tjetër 10- projekt propozimet fituese. Projektet fituese kanë dalë pas vendimit të përbashkët dhe mbledhjes që u zhvillua online (via Skype) në ambientet e Ministrisë së Arsimit, Rinisë e Sportit nga Komisioni i Përbashkët i përbërë nga përfaqësues të MASR, AKKSHI dhe CNR duke u nisur nga vlerësimet maksimale të ekspertëve vlerësues të secilës palë. Këto janë projekteve që financohen me grante të vogla, maksimumi 2,500 EURO që synojnë mobilitetin e studiuesve dhe kërkuesve shkencorë.

Znj. Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë- Duke qenë se projektet kanë kaluar të gjitha fazat e vlerësimit, atëherë propozoj të miratojmë

BORDI I ADMINISTRIMIT:

1. Znj. Lindita Nikolla, Kryetare

3. Z. Vasil Stole, Anëtar

5 Znj. Ejona Isufaj, Anëtare

2. Z. Ervin Demo, Anëtar

4. Z. Mynyr Koni, Anëtar

financimin për vitin e I-rë të Projekteve Bilaterale të Bashkëpunimit Shkencor Dypalësh Itali - Shqipëri.

Të gjithë anëtarët –Dakort. Miratohet

Z. Geron KAMBERI, Drejtor i Përgjithshëm i AKKSHI- Pika tjetër e rendit të ditës është vendim mbi shpalljen e thirrjes për aplikim me projekte, në kuadër të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit.

Znj. Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë- Pas miratimit të fushave prioritare , AKKSHI të vazhdojë me shpalljen e thirrjeve për PKKZH.

Z. Vasil TOLE, Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave, Anëtar – Do të sugjeroj një njoftim për shtyp lidhur me hapjen e thirrjeve në kuadër të Projekteve Kombëtare të Kërkim – Zhvillimit-PKKZH

Të gjithë anëtarët- Dakort.

Znj. Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë- Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Ka të bëjë me propozimin e ndarjes në zëra të buxhetit për Projektet e Kërkimit Shkencor sipas buxhetit që i ka dërguar Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë AKKSHI përmes Drejtorisë së Buxhetit e Menaxhimit Financiar.

Të gjithë anëtarët- Dakort.

Znj. Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë- Për pikën të ndryshme ia kaloj sërish fjalën Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI , z.Geron Kamberi.

Z. Geron KAMBERI, Drejtor i Përgjithshëm i AKKSHI- E nderuar zj. Kryetare. Të nderuar anëtarë të Bordit të Administrimit të AKKSHI. Më tej në pikën “Të ndryshme”, do të doja të ndaja me Bordin e Administrimit të zbatimit nga ana e AKKSHI të Programit CEEPUS. Përmes Udhëzimit Nr 4 të Ministrit të Arsimit Rinisë e Sportit, datë 16.02.2018: **AKKSHI është caktuar**, Për zbatimin e programit të shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore CEEPUS III në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të pikës g, të Nenit 4 të Udhëzimit Nr. 4 datë 16.02.2018, AKKSHI duhet, citoj :g) *t'i paguajë bursat CEEPUS kandidatëve të përzgjedhur fitues; AKKSHI u paguan studentëve të huaj fitues të bursës CEEPUS.*

BORDI I ADMINISTRIMIT:

1. Znj. Lindita Nikolla, Kryetare

3. Z. Vasil Tole, Anëtar

5 Znj. Ejona Isufaj, Anëtare

2. Z. Ervin Demo, Anëtar

4. Z. Mynyr Koni, Anëtar

Ky është një program ndërkombëtar burse që AKKSHI nuk e ka patur në fushën e tij të përgjegjësisë. Fondi për bursat e këtij programi na është alokuar në zërin buxhetor 606 për vitin 2018 nga ana e MASR. AKKSHI ka caktuar dhe NCO-Koordinatorin Kombëtar të CEEPUS që bën përzgjedhjen në sistemin on-line CEEPUS me koordinatorët CEEPUS në universitetet publike e jo publike. Por në rastin që AKKSHI bën financime, kushtëzohet nga miratimi i Bordit të Administrimit, i cili mblidhet në sipas kërkesës dhe prioriteteve. Ndërkaq studentët përfitues të këtij programi që janë nga vendet e Europës Qëndrore e Lindore, mund të vijnë si përfitues në çdo kohë dhe pa një parashikim. Nisur nga sa më sipër dhe nga fakti që Bordi i Administrimit të AKKSHI, nuk mund të mblidhet rast pas rasti për cdo student, kërkoj miratimin tuaj me anë të një vendimi për të më autorizuar në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI, për financimin rasti pas rasti që të lehtësohet procedura e pagesës së bursave CEEPUS.

Znj. Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Kryetare-Shqetësimi i Drejtorit të Përgjithshëm është i drejtë. Duke qenë se AKKSHI është caktuar të kryejë procesin e zbatimit të Programit CEEPUS, propozoj autorizimin e pagesës së bursës së çdo studenti CEEPUS që përzgjidhet on-line nga sistemi nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI. Ndërkohë anëtarëve të Bordit duhet t'u dërgohet për dijeni me shkresë zyrtare apo e-mail lista me pagesat e bëra për studentët CEEPUS në çdo rast.

Të gjithë anëtarët – Dakort. Miratohet.

Znj. Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë - Nëse nuk ka diçka tjetër, për të diskutuar e deklaroj këtë mbledhje të mbyllur.

Bordi i Administrimit

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit Vjetor të veprimtarisë së AKKSHI për vitin 2017.
2. Miratimin i fushave prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit.

BORDI I ADMINISTRIMIT:

1. Znj. Lindita Nikolla, Kryetare

3. Z. Vasil Tole, Anëtar

5 Znj. Ejona Isufaj, Anëtare

2. Z. Ervin Demo, Anëtar

4. Z. Mynyr Koni, Anëtar

3. Miratimi i financimit të projekteve fituese në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, në kuadër të marrëveshjes bilaterale midis Shqipërisë dhe Italisë.
4. Shpalljen e thirrjes për aplikim me projekte në kuadër të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, pas miratimit të fushave prioritare të kërkimit shkencor.
5. Autorizimin e Z. Geron Kamberi, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI, në zbatim të Udhëzimit Nr. 4 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Për zbatimin e programit të shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore CEEPUS III në Republikën e Shqipërisë për financimin e studentit përfitues të Programit CEEPUS rasti pas rasti, përkundrejt raportimit të secilit rast, me një informacion qarkullues zyrtar, apo me anë të një e- maili, drejt të gjithë anëtarëve të Bordit të Administrimit të AKKSHI.

Tiranë, datë 11.05.2018

Procesverbali u mbajt nga: **Znj. Evis TASELLARI** (Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit).

BORDI I ADMINISTRIMIT:

1. Znj. Lindita Nikolla, Kryetare

3. Z. Vasil Tole, Anëtar

5 Znj. Ejona Isufaj, Anëtare

2. Z. Ervin Demo, Anëtar

4. Z. Mynyr Koni, Anëtar